



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **145**

Prishtinë, më 15.4.2014, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Faton Topalli, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Ramiz Lladrovci.

Mungoi : Boban Todorović dhe Nijazi Idrizi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 8.4.2014,
3. Raporti vjetor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2013.
4. Raporti vjetor i Zyrës rregullator për ujëra e kanalizim për vitin 2013.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me shtesë për të shqyrtuar projektligjin për Obiliqin-Amendamentet.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8.4.2014

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 8 prill 2014.

3. Raporti vjetor i Agjencisë për komplekse memoriale

Kryetari Nait Hasani përshëndeti drejtorin e agjencisë **z. Idriz Blakaj** të cilit ja sqaroi takimin e komisionit me ministrin e MMPH, ndaj pasi janë mbetur ende dilemat ftoi të njëjtin të vazhdoi raportimin dhe sqarimet e mëtejme. Drejtori fillimisht konstatoi se ballafaqimi me kompetentët e MMPH do të ishte rruga më e mirë, megjithatë lidhur me sfidat e mospajtimeve përsëriti gjërat që i ka thënë në mbledhjen e parakaluar rreth mungesës së stafit, projekteve etj të cilat i argumentoi duke prezantuar kërkesat me shkrim që i ka bërë menjtëher pas miratimit të ligjit. Argumentimi siç tha ai, do të ishte më i plotë poçes do të ishte prezent ministri ngase mohimi i fakteve më lehtë është të bëhet nëse nuk është prezent. Sa i përket heqjes së dy faqeve nga raporti sipas kërkesës së ministrit, ai tha se nuk ka kurfar obligimi ndaj ministrit, ngase duke i parë të gjitha shkeljet e rënda ligjore, te ai ka lindur dyshimi për korrupsion, gjithashtu ceku projektin në Marinë e Likoshan ku fillimisht ka qenë dedikuar shuma prej 400.000 euro.

Ramiz Lladrovci përsëriti disa pretendime nga dy mbledhjet e kaluara ngase siç tha ai një person me një asistent (agjencia pa staf) nuk mund të jap material të mjaftueshëm për një prokurori, gjithashtu tha se nuk është në rregull që për një gjelbërim dhe 16 km gypa të harxhohen 800.000 euro, ndaj i sugjeroi kryetarit që nëse nuk plotësohet ky raport, mos të miratohet nga ky komision. **Salih Morina** pohoi se ballafaqimi me ministrin nuk ka pasur mjaft efekte, ndaj shprehu dyshimin për miratimin e këtij raporti nga ky komision, ndërsa mbledhjes plenare i mbetet, nëse dëshirojnë deputetët me ministrin të sqarojnë faktet dhe të miratojnë këtë raport. Gjithashtu edhe **Faton Topalli** tha edhe poçes do të vazhdoja pyetjet për parregullësi, ishte i mendimit se raporti ka të meta dhe nuk ofron qartësi ngase ligji për agjenci fare nuk ka funksionuar. Një raport i tillë nuk mund të vlerësohet nga ky komision.

VËREJTJE : disa diskutime të deputetëve (të cilat janë incizuar) ishin përsëritje nga dy mbledhjet e kaluara dhe pa ndonjë risi, ndaj stafi nuk i shënoi në procesverbal ngase ishin të tipit të komunikimit të shpejt.

Kryetari Nait Hasani pas konsultimeve me komisionin konstatoi se raporti është jo i plotë, ka paqartësi dhe nuk është i arsyetuar, ndaj sugjeroi, ndërsa komisioni nxori :

R e k o m a n d i m

Të mos miratohet Raporti vjetor i Agjencionit për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2013.

4. Raporti vjetor nga ZRRUK

Kryetari Nait Hasani përshëndeti drejtorin e ZRRUK **Raif Preteni me bashkëpunëtorë**, nga i cili zyre edhe këtë vit komisioni ka pranuar një raport bukur më të avancuar se vitet e kaluara mirëpo nuk do të thotë kjo se janë eliminuar problemet me të cilat ka punë kjo zyre, siç janë faturimi dhe ujëmatësit. Pasi që drejtori zyrës informoi shkurtimisht për raportin, kryetari i japi fjalën anëtarëve të komisionit **Faton Topalli, Ramiz Lladrovci, Sevdije Lama, Afërdita Berisha** të cilët sugjeruan dhe parashtruan pyetjet për kompletuar informimin sa më të plotë rreth këtij raporti. Rreth pyetjeve të parashtruara nga Faton Topalli, drejtori i zyrës fillimisht njoftoi se Mitrovica veriore nuk është nën ombrellën e kësaj zyre shpenzimet ujore të së cilës hiqen nga Qeveria çdo muaj. Në pyetjen shtesë se a paguan Qeveria edhe diku tjetër, përgjigja ishte se nuk kanë informatë lidhur me këtë çështje. Rreth pyetjes në faqen 13 për Shterpcë dhe Kaqanik kjo zyre ka gjobitë kompaninë për shkak të licencës dmth funksionim ilegal dhe në vazhdim pritet që edhe këto dy komuna të hynë nën ombrellën e zyrës. Për përqindjen dhe ndryshimin e lartësive të shumave të arkëtuara në përgjithësi, drejtori tha se ndikon një rajon si p.sh. Mitrovica ka mjaft raste sociale etj. Lidhur me investime ai tregoi se janë dakorduar të gjitha komunat rreth pronësisë së aseteve se investitorët nuk do të ofrojnë mbështetje financiare pa ditur se të kujt janë

asetet. Përgjigjet në pyetjet tjera ishin rreth kualitetit të ujit ku mbulueshmëria i takon kompanive dhe regjistrimit të banorëve nëpër ndërtesa kolektive ku nuk ka ujëmatës, ndërsa sa i përket humbjeve të ujit ende është gjendja mjaft alarmante me vetëm 1% zbritje nga 58 në 57%. **Sevdije Lama** pyeti rreth kualitetit të ujit në qytetin e Pejës ku mungojnë listat e banorëve-konsumatorëve dhe zbatimit të vendimit për paushallë, në të cilin pyetje drejtori u përgjigj se kjo procedurë është në vazhdim e sipër, jo vetëm në Pejë por në tërë Kosovën, ngase me evidentimin e konsumatorëve do të eliminohen problemet rreth pagesave sipas banorëve sa janë e jo paushallë, njëherit ai theksoi se ky problem është më i madh në Prishtinë. Pasi që anëtarët e komisionit u pajtuan se kemi të bëjmë me një raport pozitiv, komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Rekomandohet mbledhjes plenare miratimi i raportit vjetor për vitin 2013 nga ZRRUK.

5. Rekomandimet për projektligjin për Obiliqin

Kryetari Nait Hasani ftoi komisionin dhe propozuesin e ligjit z. **Agim Kuleta** të unifikohen amendamentet rreth projektligjit në fjalë të cilat u miratuan si vijon :

Amendamenti 1

Në preambulë fshihet fjalia “**Me qëllim të krijimit të standardeve mjedisore në harmoni me ato të Bashkimit Evropian,**”

Amendamenti 2

Neni 1, riemërohet dhe riformulohet si vijon:

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e Komunës së Obiliqit dhe rrethit të tij si zonë me rrezik të veçantë mjedisor, si pasojë e ndotjes së vazhdueshme të ajrit, tokës dhe ujit si dhe përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

Amendamenti 3

Neni 2, riemërohet dhe riformulohet si vijon:

Fushëveprimi

1. Me këtë ligj rregullohen kushtet e përgjithshme për përcaktimin e zonës së rrezikuar mjedisore të komunës së Obiliqit dhe rreth saj, mënyra e financimit, si dhe mekanizmat institucionalë për zbatimin e këtij Ligji, nëpërmjet të:
 - 1.1. përcaktimit të kufijve të zonës së rrezikuar dhe të mbrojtur nga ndotja e mjedisit që vjen si rezultat i aktiviteteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të termocentraleve dhe operatorëve të tjerë ndotës që operojnë në zonën e Obiliqit dhe rreth saj;
 - 1.2. përcaktimit të rrezes së Zonës së Rrezikuar, duke u bazuar në masën e ndotjes dhe në shkallën e rrezikshmërisë;
 - 1.3. përcaktimit të përgjegjësisë institucionale dhe shtetërore për inicimin dhe realizimin e politikave të veçanta, duke ua përshtatur specifikave të zonës së ndotur dhe të rrezikuar;
 - 1.4. përcaktimit të institucioneve përgjegjëse dhe masave të nevojshme për trajtimin dhe përdorimin e gropave të mihjeve, grumbujve të hirit dhe thëngjillit;
 - 1.5. krijimit të politikave dhe veprimeve të nevojshme institucionale në dobi të banorëve duke trajtuar nevojat e tyre shëndetësore që vijnë si rezultat apo si pasojë e jetesës në mjedis të ndotur;
 - 1.6. ndërtimit të mekanizmit financiarë për realizimin e politikave shtetërore në funksion të përcaktimit dhe menaxhimit të zonës me status të veçantë mjedisor.
 - 1.7. ofrimit të mundësisë për qasjen e komunës së Obiliqit në projektet e kogjenerimit
 - 1.8. hartimit të planit dinamik për zhvendosjen e banorëve nga zonat me interes të veçantë.

Amendamenti 4

Neni 3, riformulohet si vijon:

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

- 1.1. **“Banorë** janë banorët e përhershëm që jetojnë në Zonë;
- 1.2. **“Zona”** është zona e rrezikuar mjedisore e Obiliqit dhe rreth tij;
- 1.3. **“Komuna”** është Komuna e Obiliqit;
- 1.4. **“Ministria”** është Ministria përgjegjëse për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
- 1.5. **“Qeveria”** është Qeveria e Republikës së Kosovës
- 1.6. **“Mjedis”** është rrethina natyrore: ajri, toka, uji, klima, flora dhe fauna, në tërësinë e ndërveprimit dhe trashëgimia kulturore si pjesë e rrethinës të cilën e ka krijuar njeriu;
- 1.7. **“Rripi i sigurisë”** është një rrip dheu përreth burimit të ndotjes, me lartësi të nevojshme, të gjelbëruar me bar dhe drunj, i cili do të ndikonte në zvogëlimin e ndotjes akustike dhe formave të tjera të ndotjes;
- 1.8. **“Ndotja e mjedisit”** është ndikimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë të materieve ndotëse në mjedis, të shkaktuara përmes aktiviteteve të personave juridikë e fizikë që kanë pasojë të dëmshme në cilësinë e mjedisit dhe në shëndetin e njeriut;
- 1.9. **“Operatorë ekonomik”** janë kompanitë që veprojnë në zonë, e të cilat me ushtrimin e aktivitetit të tyre shkaktojnë dëme në mjedis;
- 1.10. **“Burim i ndotjes”** konsiderohen: Mihjet sipërfaqësore; Gropat e mihjeve; Grumbujt e hirit dhe thëngjillit; Termocentralet; Deponite e mbeturinave.
- 1.11. **“Granti për Zonën e Veçantë”** është grant i veçantë, i cili ndahet nga Qeveria e Republikës së Kosovës për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij.

Amendamenti 5

Neni 4, Paragrafi 1 dhe 2 bashkohen dhe riformulohen si vijon:

Komuna e Obiliqit shpallet si zonë me status të veçantë mjedisor në Republikën e Kosovës.

Amendamenti 6

Neni 5, riformulohet

Zona e rrezikuar mjedisore

1. Zona e rrezikuar mjedisore përfshinë rrezen në distancë ajrore deri pesëmijë (5000) metra nga pika në mes dy termocentraleve në Obiliq.
2. Komuna në bashkëpunim me Ministrinë, përcakton prioritetet për investime brenda zonave të përcaktuara, në bazë të shkallës së ndotjes.

Amendamenti 7

Neni 6, riformulohet titulli i nenit:

“Masat mbrojtëse nga burimet e ndotjes”

Paragrafi 1, ne rreshtin e parë pas fjalës **“Ministrinë”** fshihet togfjalëshi **“si dhe në konsultim me Komisionin Mbikëqyrës Qendror Shtetëror,”**

Paragrafi 2, hiqet togfjalëshi **“sidomos arritjen e qëllimeve si në vijim.”**

Nënparagrafi 2.1. fjala **“evropiane”** bëhet **“mjedisore”**.

Amendamenti 8

Neni 7, Paragrafi 1

në rreshtin e dytë pas lidhës **“me”** shtohet **“Komunën dhe”** dhe vazhdon teksti

Paragrafi 2, në fillim togfjalëshi **“Komuna, në bashkëpunim me Ministrinë, bën”** riformulohet **“Komuna dhe Ministria bëjnë”**

Paragrafi 3, Pas fjalës **“Ministrisë”** shtohet **“dhe operatorëve ekonomik”**

Paragrafi 4, fshihet **“zhurma”** dhe në fund shtohet sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Zhurma.

Amendamenti 9

Neni 8, Riformulohet si vijon:

Masat shtesë për përmirësimin e jetës së banorëve të Zonës së Veçantë

1. Qeveria në bashkëpunim me Komunën, krijon lehtësira të vazhdueshme për banorët e Zonës së Veçantë,
2. **Qeveria në bashkëpunim me Zyren e Rregullatorit të Energjisë siguron:**
 - 2.1. një kuotë më të ulët të çmimit për energji elektrike,
 - 2.2. furnizim të rregullt me energji elektrike për banorët e zonës.
3. **Qeveria në bashkëpunim me operatorët siguron:**

- 3.1. Trajtim me përparësi në kushte të barabarta, për ata që janë banorë të zonës së veçantë së paku 5 vite, në procedurat e punësimit për profesionet dhe vendet e punës që gjenerohen nga mihjet sipërfaqësore dhe prodhimi i energjisë elektrike, në përputhje me procedurat ligjore të Republikës së Kosovës.
- 3.2. Mundësi qasjeje në shfrytëzimin e avullit të termoelektranave për ngrohje qendrore.
4. Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Komunën, krijon kushtet e nevojshme në fushën e shëndetësisë, të cilat duhet të përfshijnë:
- 4.1. shërbimet shpesh shëndetësore për të prekurit nga sëmundjet e rënda si pasojë e ndotjes së mjedisit;
- 4.2. rritjen e numrit të personelit të përgjithshëm dhe të specializuar mjekësor, me theks të veçantë të specialistëve të profilit të sëmundjeve që konsiderohet se shkaktohen nga ndotja mjedisore;
- 4.3. **krijimin e hapësirave dhe** pajisjen e institucioneve shëndetësore të zonës me aparaturë adekuate për analiza dhe diagnostifikim të hershëm të sëmundjeve.
5. Komuna, në bashkëpunim me **operatorët ekonomik**, përcakton dhe zbaton politika të vazhdueshme në krijimin e infrastrukturës dhe stimulimin e aktiviteteve të veçanta sportive dhe kulturore.

Amendamenti 10

Neni 9, riformulohet paragrafët si vijon:

Paragrafi 1. fjala “**të përhershëm**” zëvendësohet me “**të veçantë**”

Paragrafi 2, pas fjalës “**Obiliqit**” fshihet pjesa në vazhdim

Paragrafi 3. dhe **nëparagrafi 3.1.** fjala “**Granti**” zëvendësohet me “**buxheti**”

Nëparagrafi 3.2. fjala “**Donacioneve.**” zëvendësohet me “**dhe format e tjera të financimit**”

Amendamenti 11

Neni 10, riformulohet paragrafët si vijon:

Paragrafi 1. pas fjalës “**mjedisit**” shtohet “**dhe planifikimit hapësinor**”

Paragrafi 3, fshihet

Paragrafi 4. në fund të fjalise pas lidhëses “**dhe**” pjesa tjetër riformulohet si vijon: “**Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë si dhe Ligjin për financat e pushtetit lokal.**”

Paragrafi 5, pas fjalës “**Ligji**” pjesa tjetër e tekstit fshihet

Amendamenti 12

Neni 11, fshihet

Amendamenti 13

Neni 12, riformulohet si vijon:

Qeveria dhe ministrinë përkatëse me Komunën brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

- Kryetari obligoi koordinatorin për të kontaktuar me ambasadën e Shqipërisë rreth vizitës në Shqipëri rreth këtij ligji, mundësisht javën tjetër për tu realizuar, me mbështetjen financiare nga donatori i caktuar nga komuna e Obiliqit. Do të udhëtoi komisioni komplet.
- Komisioni do të vizitoi Prevallën të premtën sipas kërkesës së Komisionit parlamentar për drejtat e njeriut, ku është parashtruar peticioni rreth ndërtimeve pa leje në Prevallë.

Mbledhja përfundoi në orën 13,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani